



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
NJËSIA E INSPEKTORËVE**

Nr. 1388 prot.,

Datë 05.05. 2025

RAPORT

“PËR

**KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT “MBI PROCEDURËN
E SHPALLJES DHE ARSYETIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER DHE SHKODËR, PËR PERIUDHËN
01.01.2023-01.06.2023”**

Në zbatim të vendimit nr. 14, datë 02.04.2024 “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023”,
të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Tiranë, 05.05.2025

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik me objekt "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023",
të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Data e përgatitjes:

05.05.2025

Përgatitur nga:

znj. Erjena Bashari
znj. Joana Sorraj

Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

z. Artur Metani

Miratoi ☐ Ndryshoi ☐ Ktheu ☐

Date 05.05.2025



I. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenet 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja "dh", "ë" dhe "k" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 "*Planin e inspektimeve për vitin 2024*".

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 "*Planin e inspektimeve për vitin 2024*" është planifikuar zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt: "*Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023*".

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 14, datë 02.04.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u angazhuan inspektorët, znj. Erjena Bashari dhe znj. Joana Sorraj. Gjithashtu, me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministritimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektori znj. Erjena Bashari.

Për realizimin e këtij inspektimi, me vendimin nr. 14/1, datë 27.12.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është kryer shtyrja e afatit për përfundimin e këtij inspektimi, pasi është vlerësuar e nevojshme marrja e informacionit shtesë nga gjykatat objekt inspektimi, për shkak të specifikës së çështjeve penale në lidhje me mënyrën e vendimit të tyre dhe trajtimit me afate të ndryshme në dorëzimin e vendimit të arsyetuar.

Arsyeja e iniciimit të këtij inspektimi konsiston në një numër të lartë ankesash të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të cilat ngriheshin pretendime për vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Ndërsa për Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nisur nga numri i madh i çështjeve që kjo gjykatë ka në shqyrtim, Zyra e ILD-së nisi këtë inspektim tematik, për të krijuar një pasqyrë reale të gjendjes faktike të dorëzimit të vendimeve gjyqësore të përfunduara nga ana e magjistratëve.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së gjyqtarëve lidhur me objektin e inspektimit janë:


- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë;



- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2023;
- Analiza vjetore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitin 2023;
- Rregullore e veprimtarisë administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier miratuar me Urdhrin e datës 12.12.2014 të Kryetarit të Gjykatës;
- Analiza e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2023;
- Rregullore për përdorimin e pajisjeve elektronike, shërbimit të internetit dhe hedhjen e të dhënave personale dhe aksesimi e tyre në sisteme elektronike, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Vendim i KLGJ nr. 150, datë 29.03.2023 për Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë me Zyra Shërbimi”;
- Vendimit nr. 4, datë 31.03.2023 të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Kryerja e inspektimit është planifikuar sipas vendimit të inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akteve”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga inspektorët në datë 02.04.2024;
 - b) Janë hartuar shkresat drejtuar gjykatave objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga inspektorët, të cilat për të dy gjykatat janë nisur në datën 02.04.2024;
 - c) Është administruar informacioni dhe dokumentacioni sipas gjykatave përkatëse dhe përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
 - b) Vlerësimin nëse duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar nga grupi i inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: “Hartimi i Raportit të Inspektimit”, që ka përfshirë këto hapa:
 - a) Hartimi i raporteve të veçanta për secilën nga gjykatat që janë përfshirë në inspektim, sipas një model/strukture të njëjtë;
 - b) Hartimi i projekt raportit përfundimtar, i cili do të dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



Pas shqyrtimit dhe daljes së Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

- 4) Faza e katërt: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit”.
- Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmblodhur problematika të lidhura me:
 - Paraqitjen e paplotë të informacionit të kërkuar nga gjykatat objekt inspektimi në lidhje me datat e komunikimeve të vendimeve palëve ndërgjyqëse për shkak të mungesës së regjistrave të posaçëm për mbajtjen e këtyre të dhënave.
 - Paraqitjen me vonesë të informacionit dhe të dhënave të kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi për shkak të volumit të madh të punës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mungesës së punonjësve të administratës gjyqësore.
 - Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e gjykatave subjekt të këtij inspektimi, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023.
 - Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në tre drejtime kryesore:
 - (i) Datën e shpalljes së vendimit gjyqësor;
 - (ii) Datën e depozitimit të vendimit të arsyetuar në sekretari;
 - (iii) Datën e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve.

Qëllimi i këtij inspektimi është vlerësimi i praktikave të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, lidhur me zbatimin e kriterëve ligjore mbi shpalljen dhe depozitimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara në sekretari duke informuar me vërtetësi mbi gjendjen e organit të inspektuar.

Në këtë inspektim është vlerësuar veprimtaria e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në respektimin e afateve ligjore të përcaktuara për shpalljen dhe dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në sekretari.

Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë objektit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektimi tematik paraqet rëndësi në krijimin e një panorame të përgjithshme mbi zbatimin e afateve ligjore në zbardhjen e vendimeve gjyqësore dhe dorëzimit të dosjeve në kryesekretarinë e gjykatave, për të vijuar me komunikimet e vendimeve palëve, për të siguruar njoftimin në kohë dhe fillimin e afatit të ankimit, pa sjellë vonesa për palët ndërgjyqëse dhe në zbatimin të përcaktimeve ligjore për këtë qëllim.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, mundësoi njohjen dhe krijimin e një tabloje të përgjithshme mbi respektimin e afateve ligjore për arsyetimin e vendimeve gjyqësore të shpallura si dhe depozitimin e tyre së bashku me dosjet në sekretari nga magjistratët gjyqtarë.

- Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2023 deri më 01.06.2023 rezultoi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë shpallur:

- **496 vendime civile të themelit** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 433 vendime ose 87.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituara në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 31 vendime ose 6.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 21-30 ditor, 22 vendime ose 4.4 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 31-60 ditor, 9 vendime ose 1.8 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 61-90 ditor, 2 vendime ose 0.4 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 91-120 ditor, 0 vendime ose 0% e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari mbi afatin 121 ditor, i padorëzuar deri në datën 20.05.2024 nuk rezulton asnjë vendim.

- **532 vendime kërkesa civile** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 489 vendime ose 92 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 31 vendime ose 5.8 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 21-30 ditor, 11 vendime ose 2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 31-60 ditor, 0 vendime ose 0 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 91-120 ditor, 1 vendim ose 0.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari mbi afatin 121 ditor.

- **268 vendime penale themeli**, të cilat për shkak të afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, janë kategorizuar sipas afateve të dorëzimit të tyre pas shpalljes së vendimit në penale themeli ku personi i dënuar është me masë sigurimi personal të cilat në total për periudhën e inspektuar janë **49 çështje** dhe në penale themeli me të dënuar pa masë sigurimi personal të cilat në total janë **219 çështje**. Për shkak të afateve ligjore të ndryshme që përdoren për secilën prej kategorive, në pjesën e analizës ligjore të këtij inspektimi gjendet kategorizimi i çështjeve në raport me afatet ligjore të parashikuara nga KPP.

- **232 vendime të seancave paraprake**. Për shkak të parashikimit të përcaktuar në nenin 332/dh përsa i përket këtyre çështjeve, në varësi të “germës” të nenit të cilit i përgjigjen natyra e vendimmarrjes së gjykatës si dhe parashikimi ligjor përkatës, trajtohen me afate të ndryshme dorëzimi pas dhënies së vendimit. Në këtë optikë ndarja për secilën kategori është e pasqyruar në pjesën e analizës ligjore të këtij raporti. Në totalin e vendimeve të

seancave paraprahe për periudhën e inspektuar rezultuan që **205** çështje janë trajtuar sipas germës “c” të cilat i referohen afateve të dorëzimit të parashikuar në nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale dhe **27** çështje të cilat janë trajtuar sipas germës “a” të nenit 332/dh dhe për të cilat afati i parashikuar për dorëzimin e vendimit pas shpalljes së tij është 10 ditore.

- **119** vendime **pushim procedimi**, të cilat janë trajtuar nga kjo gjykatë për periudhën e inspektuar dhe të cilat përsa i përket afatit të dorëzimit të tyre pas shpalljes së vendimit trajtohen sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale.

- **638** vendime **kërkesa penale**, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat që lidhen me masat e sigurimit personat që janë **170** për periudhën e inspektuar, kërkesat për lejim përgjimi dhe zgjatje afati për lejim përgjimi të cilat janë **9**, kërkesat për shuarjen e masave të sigurimit të cilat për periudhën e inspektuar janë **27** dhe të gjitha kërkesat e tjera penale të cilat ngrihen pranë gjykatës pas dhënies së vendimit të themelit të cilat janë **432** për periudhën e inspektuar.

Numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është 21, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023 është 10.8 pra 51%. Ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier 851.5 çështje.

- Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2023 deri më 01.06.2023 rezultoi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër janë shpallur:

- **294** vendime **civile të themelit** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 119 vendime ose 40.5 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditore, 114 vendime ose 39 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 21-30 ditore, 3 vendime ose 1 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 31-60 ditore, 9 vendime ose 3 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 91-120 ditore, 15 vendime ose 5% e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari mbi afatin 121 ditore.

- **426** vendime **kërkesa civile** të cilat nuk janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 350 vendime ose 82 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditore, 38 vendime ose 9 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 21-30 ditore, 3 vendime ose 0.8 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 31-60 ditore, 5 vendime ose 1.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 91-120 ditore, 28 vendime ose 6.5 % e totalit të vendimeve të shpallura janë të padorëzuara deri në datën 07.05.2024.

- **424** vendime **penale themeli**, të cilat për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale, janë kategorizuar sipas afateve të dorëzimit të tyre pas shpalljes së vendimit në, penale themeli me të dënuar me masë sigurimi personal të cilat në total për periudhën e inspektuar janë **63 çështje** dhe në penale themeli me të dënuar pa masë sigurimi personal të cilat në total janë **361** çështje. Për shkak të afateve që përdoren për secilën prej kategorive, në pjesën e analizës së këtij inspektimi gjendet kategorizimi i çështjeve në raport me afatet ligjore të parashikuara nga KPP.

- **111** vendime të **seancave paraprahe**. Për shkak të parashikimit të përcaktuar në nenin 332/dh përsa i përket këtyre çështjeve, në varësi të “germës” të neni të cilit i përgjigjen natyra e vendimmarrjes së gjykatës si dhe parashikimi ligjor përkatës, trajtohen me afate të ndryshme dorëzimi pas dhënies së vendimit. Në këtë optikë ndarja për secilën kategori është e pasqyruar në pjesën e analizës ligjore të këtij raporti. Në totalin e vendimeve të seancave paraprahe për periudhën e inspektuar rezultuan se janë trajtuar sipas germës “c”, të cilat i referohen afateve të dorëzimit të parashikuar në nenin 382 të Kodit të Procedurës Penale dhe **111** çështje të cilat janë trajtuar sipas germës “a”, të nenit 332/dh dhe për të cilat afati i parashikuar për dorëzimin e vendimit pas shpalljes së tij është 10 ditore.

- **572** vendime **pushim procedimi**, të cilat janë trajtuar nga kjo gjykatë për periudhën e inspektuar dhe të cilat përsa i përket afatit të dorëzimit të tyre pas shpalljes së vendimit trajtohen sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale.

- **718** vendime **kërkesa penale**, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat që lidhen me masat e sigurimit personat të cilat janë **194** për periudhën e inspektuar, kërkesat për lejim përgjimi dhe zgjatje afati për lejim përgjimi të cilat janë **75**, kërkesat për shuarjen e masave të sigurimit të cilat për periudhën e inspektuar janë **14** dhe të gjitha kërkesat e tjera penale të cilat ngrihen pranë gjykatës pas dhënies së vendimit të themelit të cilat janë **435** për periudhën e inspektuar.

Numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është 15 ,ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023 është 9.1 pra 61%. Ngarkesa mesatare e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është 829 çështje.

Pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil dhe penal, rezulton se këto afate jo gjithmonë mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, për shkak të ngarkesës së shtuar dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën për periudhën e inspektuar. Pra, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezulton se: 97.8 % e vendimeve civile të themelit, rreth 99 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 60 ditore, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, për këtë periudhë të inspektuar, në kushtet që është ndodhur gjykata në këtë interval kohor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 79.6 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, rezulton se: 80.2 % e vendimeve civile të themelit, rreth 91.7 % e kërkesave civile janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, për këtë periudhë të inspektuar, në kushtet që është ndodhur gjykata në këtë interval kohor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi rreth 63.9 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve, secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës. Sa i përket problematikave të konstatuara gjatë inspektimit të hasura në lidhje me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore duhet mbajtur në konsideratë se një faktor i rëndësishëm është edhe situata reale e administratës gjyqësore në gjykatat e vendit. Kjo e lidhur me mënyrën e organizimit të punës, realizimit të detyrave nga stafi përgjegjës i administratës gjyqësore, përgjegjësia e sekretarit të seancës për dorëzimin e dosjes, si dhe e sekretarit gjyqësor për plotësimin e librit të pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve. si p. sh., kalimi i dosjes gjyqësore nga momenti i arsyetimit nga gjyqtari tek dorëzimi i arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Gjatë inspektimit u konstatua që gjykatat objekt inspektimi nuk kanë librin e pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve (*pra kalimi i dosjes gjyqësore pas arsyetimit të vendimit nga gjyqtari tek sekretari i seancës*).

Marrë në konsideratë sa më sipër, pavarësisht parashikimeve ligjore evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës. Në funksion të respektimit të afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore, do ishte e udhës që libri i pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve të mbante datën e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari tek sekretari i seancës, nga sekretari i seancës tek sekretari gjyqësor, të numërtohet në çdo fletë, të nënshkruhet nga Kancelari/Sekretari i seancës/sekretari gjyqësor.

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Inspektimi Tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesave për informacion dhe akteve drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku është mundësuar marrja e informacionit dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet shkresave të dërguara nga kjo zyrë, me nr. 3245/1 prot., datë 22.04.2024^[1], nr. 3245/2 prot., datë 29.04.2024^[2], nr. 3245/3 prot., datë 08.05.2024^[3], nr. 3245/4 prot., datë 15.05.2024^[4] dhe nr. 13257/1 prot., datë 20.01.2025.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresave me nr. 636/3 prot., datë 02.05.2024^[5] dhe nr. 636/6 prot., datë 12.02.2025 si dhe në mënyrë elektronike^[6].

Të dhënat e marra nga gjykatat sa më sipër lidhen me informacionin dhe dokumentacionin shkresor të mëposhtëm gjatë periudhës kohore objekt të inspektimit 01.01.2023-01.06.2023:

- i. Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- ii. Informacion nominal për gjyqtarët e secilës gjykatë, në lidhje me numrin e çështjeve të shpallura dhe momentin e dorëzimit të tyre në kryesekretari, për harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- iii. Çdo dokument që vërteton dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në kryesekretarinë e gjykatës;
- iv. Informacion statistikor për periudhën 01.01.2023-01.06.2023, për trendin e dorëzimit të vendimeve të shpallura;
- v. Informacion mbi datën e nisjes së njoftimit të vendimit të arsyetuar, palëve pjesëmarrëse në proces, nga kryesekretaria e gjykatës.
- vi. Tabelën e plotësuar sipas modelit të vendosur në dispozicion nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e gjykatave, është përqendruar në drejtim të (i) datës së shpalljes së vendimit gjyqësor, (ii) datës në të cilën dosja e plotë gjyqësore së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari, (iii) datën e komunikimit të vendimit gjyqësor palëve ndërgjyqëse.

- Trajtimi i këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të: Kushtetutës, Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; ligjit

¹ Regjistruar në ILD me nr. 879/6 prot., datë 23.04.2024.

² Regjistruar në ILD me nr. 879/7 prot., datë 02.05.2024.

³ Regjistruar në ILD me nr. 879/10 prot., datë 10.05.2024.

⁴ Regjistruar në ILD me nr. 879/11 prot., datë 20.05.2024.

⁵ Regjistruar në ILD me nr. 879/9 prot., datë 07.05.2024.

⁶ E-mail i kancelares datë 02.05.2024 e-maili i kancelares Fier, i datës 20.01.2025 dhe e-maili i zyrës së statistikave Shkodër datë 12.02.2025.

nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2023; Analizës vjetore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitin 2023; Vendimit të KLGJ nr. 150, datë 29.03.2023 “Për Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë me Zyra Shërbimi””, Rregullores së veprimtarisë administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier miratuar me Urdhrin e datës 12.12.2014 të Kryetarit të Gjykatës^[7]; Analizës së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2023; Rregullores për përdorimin e pajisjeve elektronike, shërbimit të internetit dhe hedhjen e të dhënave personale dhe aksesimi e tyre në sisteme elektronike, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Vendimit nr. 4, datë 31.03.2023 të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër,

Në këtë analizë është marrë në konsideratë edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e cila thekson se u takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që organet kompetente të mund të plotësojnë kërkesat e nenit 6 të Konventës, duke përfshirë dhe detyrimin për trajtimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme^[8].

Me qëllimin që analizimi i të dhënave të mbledhura të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, nga grupi i inspektimit u morën edhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vend, konkretisht raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu, në raportin vjetor të KLGJ-së për vitin 2023, referuar gjendjes së sistemit gjyqësor gjatë vitit 2023 Këshilli ndër të tjera shprehet se ky vit shënoi zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, e cila solli rikonfigurimin e shpërndarjes gjeografike të gjykatave në gjithë territorin e vendit. Sipas KLGJ edhe këtë vit, me gjithë rekrutimet e reja në sistem (gjyqtarë dhe administratë) numri i gjyqtarëve por edhe i administratës gjyqësore në raport me popullsinë, mbeten ende në nivele të ulëta krahasuar me standardet e sistemeve gjyqësore evropiane. Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultojnë se numri i i vakancave në sistem, për magjistratët (gjyqtarë) është 161 vakanca (nga të cilat 79 të përhershme dhe 82 vakanca të përkohshme. Nëse marrim në shqyrtim një ndër treguesit e menaxhimit të burimeve njerëzore që përdoret edhe nga CEPEJ, numrin e gjyqtarëve në raport me popullsinë, sikurse vihet re sipas tabelës së mëposhtme, Shqipëria është ende larg mesatares evropiane.

	Str. Organiz	Fakti	Efektivisht	Mesatarja Evropiane

⁷ Dërguar pranë ILD me e-mailin e datës 06.11.2024.

⁸ Shiko vendimin: Mishgijoni K. Shqipërisë, nr. 18381/05, datë 7 dhjetor 2010 para 59; Makarova K. Rusisë, nr. 23554/03, datë 1 tetor 2009.

Gjyqtarë/100 mijë banorë	14.80	11.92	8.94	22.2
--------------------------	-------	-------	------	------

Nga raporti i KLGJ-së referuar gjendjes së sistemit gjyqësor gjatë vitit 2023 rezulton se:

- Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, kanë funksionuar me 56% të gjyqtarëve të parashikuar.
- Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 84,382 çështje të reja (13% më pak sesa në vitin 2022). Vendin e parë me 31,883 çështje (38% e totalit) e zë Tirana, ndërsa vendin e dytë me vetëm 10% të totalit e zë Durrësi dhe më pas Fieri me 7,328 (8.7% e totalit).
- Treguesit e efencës kanë rënë lehtësisht duke shënuar:
 - Rritje të rendimentit mesatar të gjyqtarëve në këtë grup. Mesatarja e këtij treguesi është 841.7 çështje të gjykuara për gjyqtar.
 - Norma e likuidimit të çështjeve paraqitet e ndryshme për të dyja kategoritë e çështjeve. Ajo është mesatarisht 90% për çështjet civile dhe 97% për çështjet penale, por ngelet nën pragun 100%.
 - Rritje të treguesit DT (koha e nevojshme për përfundimin e një çështjeje në ditë) dhe zgjatje të afateve të nevojshme për shqyrtimin e çështjes. Një çështje civile gjykohet në shkallë të parë mesatarisht për 272 ditë, ndërsa një çështje penale për 114 ditë.
 - Gjykimi i çështjeve penale dhe civile në shkallë të parë realizohet brenda afateve të arsyeshme ligjore, në të gjitha gjykatat e vendit.
 - Ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR) dhe norma e efencës për gjyqtar (treguesi WR) tregojnë disbalancë të theksuar mes gjyqtarëve të së njëjtit nivel, shkaktuar nga numri i gjyqtarëve efektivë në detyrë i cili nuk është në % të njëjtë nga njëra gjykatë tek tjetra^[9].


Në vijim është pasqyruar analiza ligjore me të dhënat përkatëse që janë përpunuar mbi secilin subjekt të inspektimit, pas trajtimit të informacioneve të dërguara nga gjykatat, raportet vjetore të punës së secilës gjykatë, informacionit të trajtuar në raportet vjetore të KLGJ-së për këto gjykata. Pjesë e analizës ligjore për secilën gjykatë është situata aktuale që rezulton nga gjetjet e inspektimit si, ngarkesa e gjykatës duke përfshirë çështjet e mbartura nga viti i mëparshëm, ato të regjistruara rishtazi, si dhe gjendja reale e burimeve njerëzore të gjykatave.

➤ **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier**

Në përgjigje të kërkesës së ILD-së për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier^[10] vendosi në dispozicion kopje të njësuar të numërorit të vendimeve penale dhe civile të shpallura në harkun kohor

⁹ Fq. 99 e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023.

¹⁰ Me shkresën nr. 3245/1 prot., datë 22.04.2024 regjistruar pranë ILD me nr. 879/6, datë 23.04.2023.



01.01.2023-01.06.2023; numrin e përgjithshëm të çështjeve në gjykim për secilin gjyqtar në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023; kopje të njësuar të librit të dorëzimit të dosjeve penale dhe civile të arsyetuara në kryesekretarinë e gjykatës të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023; tabelën e plotësuar për dosjet penale.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier informon se tabela e plotësuar për datën e njoftimit të vendimeve të arsyetuara nga kryesekretaria e gjykatës është verifikuar në dosjet gjyqësore dhe për dosjet që janë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për shqyrtim, në tabelën që kanë plotësuar mungon data e njoftimit por në çdo rast vendimet janë komunikuar nga kryesekretaria ditën e dorëzimit të dosjes në kryesekretari.

Gjithashtu Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier parashtrohet se, në disa raste në tabelën që kanë plotësuar, data e njoftimit të palëve është para depozitimit të dosjes në kryesekretari për shkak se sekretaret kanë dhënë vendim për komunikim para dorëzimit të dosjeve.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me shkresën nr. 3245/2 prot., datë 29.04.2024 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 879/7, datë 02.05.2024 përcjell tabelën e plotësuar për dosjet penale.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me shkresën nr. 3245/3 prot., datë 08.05.2024 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 879/10, datë 10.05.2024 përcjell:

- Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve penale të veçanta të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve të seancave paraprake (dërgim në gjykim dhe pushim procedimi) të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Kopje të njësuar të librit të dorëzimit të dosjeve penale të veçanta në kryesekretarinë e gjykatës të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Kopje të njësuar të librit të dorëzimit të dosjeve të seancave paraprake në kryesekretarinë e gjykatës, të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Tabelën e plotësuar për dosjet penale të veçanta;
- Tabelën e plotësuar për dosjet seanca paraprake.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier informon se tabela e plotësuar për datën e njoftimit të vendimeve të arsyetuara nga kryesekretaria e gjykatës është verifikuar në dosjet gjyqësore dhe për dosjet që janë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për shqyrtim, në tabelën që kanë plotësuar mungon data e njoftimit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me shkresën nr. 3245/4 prot., datë 15.05.2024 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 879/11, datë 20.05.2024 përcjell:

- Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve civile të veçanta të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve të urdhrave të mbrojtjes të shpallura (në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023);
- Kopje të njësuar të librit të dorëzimit të dosjeve civile të veçanta në kryesekretarinë e gjykatës të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Kopje të njësuar të librit të dorëzimit të dosjeve urdhra mbrojtje në kryesekretarinë e gjykatës, të shpallura në harkun kohor 01.01.2023-01.06.2023;
- Tabelën e plotësuar për dosjet civile të veçanta;
- Tabelën e plotësuar për dosjet urdhra mbrojtje.

Nga shqyrtimi i librave të dorëzimit të dosjeve civile dhe të dosjeve penale si dhe të penaleve të veçanta konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna në lidhje me datën e shpalljes së vendimit, palët ndërgjyqëse, gjyqtarin që ka gjykuar çështjen dhe sekretaren e tij, si dhe datën e dorëzimit të dosjes.

Nga analiza e numërorit penal të veçanta konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, kërkuesin dhe palën kundërshtare, objektin, prokurorin, lloji i kërkesës së prokurorit, lloji i dispozitivit të vendimit, sekretarja.

Nga analiza e numërorit civil të veçantë konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, sekretaren, datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, kërkuesin dhe palën kundërshtare, objektin, llojin e dispozitivit të vendimit.

Nga analiza e numërorit të vendimeve konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, palët në proces, objektin, lloji i dispozitivit të vendimit, numri i anëtarëve të trupit gjykues, numri i përgjithshëm i seancave të zhvilluara.

Nga analiza e numërorit të vendimeve civile konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, palët, objektin, lloji i dispozitivit të vendimit, numri i anëtarëve të trupit gjykues, numri i përgjithshëm i seancave të zhvilluara.

Nga analiza e numërorit të vendimeve penale konstatohet se në të pasqyrohen ndër të tjera të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, numrin dhe datën e shpalljes

së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, të pandehurin, masën e sigurimit, prokurorin, numri i përgjithshëm i seancave të zhvilluara.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier përcjell kopje të analizës vjetore për vitin 2023 sipas të cilit trupa gjyqësore nuk është e plotësuar me numrin 21, duke qenë se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka në organikën e saj 20 gjyqtarë dhe një kryetar. Në fillim të vitit 2023, gjykimet zhvilloheshin nga 8 gjyqtarë, sepse 2 gjyqtare ishin me leje të papaguar nga KLGJ-ja. Gjatë vitit 2023, për arsye të emërimit në gjykata të tjera dhe ILD janë larguar edhe 6 gjyqtarë. Kështu, që prej datës 18.10.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, zhvillimet e seancave gjyqësore, përballohen nga vetëm 14 gjyqtarë. Në këto kushte, mbetet nevojë imediate plotësimi i numrit të gjyqtarëve për shkak të ngarkesës në punë^[11]. Në këtë gjykatë, për vitin e kaluar kanë funksionuar seksionet penale dhe civile, gjithashtu në mbështetje të nenit 28/2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar me ligjin nr. 37/2017 dhe Udhëzimit nr. 79, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Vendim të Këshillit të Gjykatës, janë caktuar si gjyqtarë të specializuar për çështjet penale me të mitur, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin, ose të mitur viktimë nga vepra penale konkretisht të gjithë gjyqtarët e seksionit penal^[12].

Nga raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2023^[13] konstatohet se numri i gjyqtarëve sipas organikës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është 21, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023 është 10.8 pra 51%. Ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është 851.5 çështje, ndërsa ngarkesa mesatare për gjyqtarë ka qenë 841.7 çështje.

Me shkresën nr. 13257/1 prot., datë 20.01.2025, ardhur pranë ILD-së me nr. 879/18 prot., datë 24.01.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka përcjellë informacionin shtesë të kërkuar, ekzaktësisht “.....Tabelën e plotësuar me dosjet penale të veçantë... Tabelën për dosjet penale me objekt “Pushim Procedimi”.... Tabelën e plotësuar për dosjet penale me objekt “Dërgim në gjykim”..... Tabelën e plotësuar për dosjet penale themeli”. Gjithashtu të njëjtat të dhëna janë dërguar nga ana e kësaj gjykate me e-mailin e datës 20.01.2025.

➤ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në përgjigjen e saj^[14] vendosi në dispozicion të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

¹¹ Fq. 19 e analizës vjetore.

¹² Fq. 4 e analizës vjetore.

¹³ Marrë nga faqja zyrtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹⁴ Me shkresën nr. 636/3 prot., datë 02.05.2024 regjistruar pranë ILD me nr. 879/9, datë 07.05.2024.

- Numërorin civil 2023 për periudhën 01.01.2023-31.05.2023 (përfshihet data 31.05.2023) -1 libër;
- Numërorin penal për të miturin 2023 për periudhën 01.01.2023-31.05.2023 (përfshihet data 31.05.2023) -1 libër;
- Numërorin penal 2023 për periudhën 01.01.2023-31.05.2023 (përfshihet data 31.05.2023) këtu përshihen regjistrat numërorë copë 4, që pasqyrojnë çështjet penale të vendimuara deri në datë 31.05.2023 (përfshirë këtë datë) konkretisht nga nr. rendor 1-1060- 4 libra;
- Tabelat e plotësuara të ndara në dy kategori penale dhe civile;
- Kopje të njësuar të librit të dorëzimit të dosjeve gjyqësore nga data 1 janar-31 maj 2023 (përfshirë edhe këtë datë);
- Tabelat statistikore mbi ngarkesën nominale të gjyqtarëve që kanë gjykuar gjatë periudhës së inspektimit 01.01.2023-31.05.2023 konkretisht numrin e çështjeve që kanë pasur në ngarkim, numrin e çështjeve që kanë pasur në ngarkim, numrin e çështjeve të shpallura gjatë periudhës së inspektimit, duke evidentuar edhe njëherë sipas gjyqtarëve datat e dorëzimit të dosjeve për çdo çështje të shpallur në këtë hark kohor si dhe fillimin e procedurës së njoftimit të vendimit të arsyetuar nga ana e kryesekretarisë;
- Përsa i përket dosjeve të padorëzuara ato janë lënë pa shënim.

Gjatë kryerjes së inspektimit pas kërkesës së inspektorëve përgjegjës me e-mailin e datës 06.11.2024 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër përcjell kopje të analizës vjetore të punës për vitin 2023, nga ku rezulton se:

- Pranë kësaj gjykate kanë funksionuar seksionet civil, penal dhe penal për të mitur.

- Numri i gjyqtarëve në raport me organikën e miratuar ka qenë me mungesa dhe si më poshtë:

- Vitin 2023 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e filloi me trupë gjyqësore të përbërë nga 7 (shtatë) gjyqtarë organikë dhe 2 (dy) gjyqtarë të transferuar (një në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe një në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut Strasburg).
- Më datë 01.02.2023, i ka mbaruar transferimi gjyqtarit T. S., me vendimin nr. 47, datë 27.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur: Përfundimi përpara afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtarin T. S., vendim që i ka filluar efektet në datë 01.02.2023.
- Më datë 28.02.2023 referuar vendimit nr. 69, datë 09.02.2023 KLGJ-ja ka deklaruar përfundimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin H. S., për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.
- Më datë 14.04.2023 me vendim të KPK-së është shkarkuar gjyqtarja I. R.
- Më datë 01.05.2023 referuar vendimeve nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e

funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nr. 146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm” dhe nr. 147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorisë së gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i janë bashkuar trupës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, përkatësisht magjistratët A. S., dhe A. K., si dhe ka mbaruar periodha e transferimit të gjyqtarës K. K.

- Prej datës 01.05.2023 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka funksionuar nga 15 gjyqtarë organikë me 10 gjyqtarë në fakt. Ky numër gjyqtarësh ka ndryshuar në muajin shtator dhe tetor për shkak të transferimeve të 2 gjyqtarëve dhe emërimit të tre magjistratëve trupë gjyqësore që ka vijuar deri në përfundim të vitit 2023.

- Ngarkesa e seksionit penal vijon të jetë e madhe duke marrë parasysh dhe ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë rritur rolin e gjykatës, si dhe faktit që në juridiksionin e kësaj gjykate është edhe IEVP Reç, Malësi e Madhe dhe kërkesat e shtetasve që vuajnë dënimin pranë këtij institucioni janë të shumta duke rritur kështu ngarkesën e seksionit penal të kësaj gjykate. Një arsye tjetër është edhe implementimi i hartës së re gjyqësore duke rritur kështu juridiksionin territorial.

- Ngarkesa e seksionit civil është po ashtu në rritje gjatë vitit 2023 në dhomën civile për shkak të ndryshimeve të pësura në trupën gjyqësore të kësaj gjykate gjatë vitit 2022 shkarkimit të 2 gjyqtarëve seksioni ka funksionuar mesatarisht me 4.5 gjyqtarë që kanë qenë të ndryshueshëm si është pasqyruar në hyrje të kësaj analize. Për pasojë numri i çështjeve civile në mbartje për vitin 2023 ka qenë i madh. Seksioni civil ka gjykuar edhe çështjet e hetimit paraprak për shkak të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale duke mos ezauruar trupat gjykues të kësaj gjykate.

- Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në Dhomën Penale funksionon Seksioni për të Mitur, i cili përbëhet nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë, që gjykojnë njëkohësisht edhe çështjet për të rritur.

Nga Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2023^[15] konstatohet se numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është 15, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023 është 9.1 pra 61%. Ngarkesa mesatare e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është 829 çështje, ndërsa ngarkesa mesatare është 841.7 çështje.

¹⁵ Marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në vijim të kërkesës së ILD-së drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vendosjen në dispozicion të rregullores, gjykata me e-mailin e datës 06.11.2024 ndër të tjera përcjell “Rregulloren për përdorimin e pajisjeve elektronike, shërbimit të internetit dhe hedhjen e të dhënave personale dhe aksesimi e tyre në sisteme elektronike, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër” si dhe informon se nuk ka rregullore të miratuar në përputhje me ndryshimet ligjore që kanë ndodhur vitet e fundit. Veprimtaria administrative e kësaj gjykate prej vitit 2016 e në vijim është bazuar tek ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjet e tjera ndërsa veprimtaria gjyqësore e kësaj gjykate (referuar edhe objektit të inspektimit mbi afatet e arsytimit dhe dorëzimit) ka qenë e bazuar mbi Kodin e Procedurës Civile dhe atë të Procedurës Penale si dhe vendime të ndryshme të KLD (përpara konstituimit të KLGJ-së në dhjetor të 2018) apo aktualisht të KLGJ-së. Gjithashtu gjykata thekson se me implementimin e hartës së re gjyqësore, KLGJ-ja ka miratuar rregullore mbi funksionimin e administratës gjyqësore dhe detyrave sa i përket secilit nga nëpunësit civilë gjyqësorë. Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 4, datë 31.03.2023^[16], ka vendosur detajimin e pozicioneve të punës për punonjësit e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër si dhe miratimin e përkrahimit të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas anekseve bashkëlidhur vendimit nr. 150, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përkrahimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”. Gjithsesi gjykata parashton se aktualisht nga ana e grupit të punës po punohet për krijimin e një rregulloreje në përputhje me paketën ligjore të rikrijuar në kuadër të reformës së drejtësisë të ndërmarrë vitet e fundit.

Nga shqyrtimi i librit të dorëzimit të dosjeve pranë kryesekretarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër viti 2023 konstatohet se në të gjenden rubrikat që përmbajnë të dhënat e palëve, datën e vendimit, numrin e vendimit, datat e dorëzimit tek k/sekretarja, firma e k/sekretares, emri i gjyqtarit, lloji i çështjes penale/civile.

Në numërorin e vendimeve civile në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër gjenden rubrikat që përmbajnë të dhënat mbi numrin dhe datën e vendimit, datën e paraqitjes, numrin e regjistrimit, palët (paditës, i paditur), objektin, dispozitivin, trupin gjykues, anëtarët, numrin e seancave, afatin e dorëzimit.

Në numërorin e vendimeve penale në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër gjenden rubrikat që përmbajnë të dhënat mbi numrin dhe datën e vendimit, numrin e regjistrimit, datën, të pandehurin, të dëmtuarin, prokurorin, akuzën, mënyrën e përdorimit (dispozitivi), trupin gjykues, numrin e seancave, Gjykata e Apelit.

¹⁶ Ky vendim është regjistruar me nr. 483 prot., datë 31.03.2023.

Në numërorin e vendimeve penale (të mitur) në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër gjenden rubrikat që përmbajnë të dhënat mbi numrin e vendimit, datën e paraqitjes, numrin e regjistrimit, të pandehurin, të dëmtuarin, prokurorin, akuzën, mënyrën e përdorimit (dispozitivi), trupin gjykues, numrin e seancave, Gjykata e Apelit.

Me shkresën nr. 636/6 prot., datë 12.02.2025, ardhur pranë ILD-së me nr. 879/20 prot., datë 17.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka përcjellë informacionin shtesë të kërkuar, ekzaktësisht “.....Tabelën me çështjeve penale themeli... Tabelën për dosjet penale me objekt “ Kërkesa Penale”.... Tabelën me çështjet penale me objekt “ Kërkesa penale në fazën e hetimit”..... Tabelën e plotësuar me çështjet penale me objekt “Kërkesa penale në fazën paraprake”.....”. Gjithashtu të njëjtat të dhëna janë dërguar nga ana e kësaj gjykate me e-mailin e datës 12.02.2025.

Marrë në konsideratë sa më sipër, në kuadër të një analize të gjithanshme mbi situatën faktike të gjendjes së gjykatave është i domosdoshëm krijimi i një panorame të plotë referuar ligjit procedural civil dhe penal, si dhe praktikës gjyqësore në raport me objektin e inspektimit me tematikë “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023”.

Referuar kuadrit ligjor në fuqi janë përcaktuar qartë detyrimet e magjistratëve në realizimin e detyrave të tyre funksionale, në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien dhe sigurimin e drejtësisë në shoqëri, ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Në referim të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë^[17] dhe asaj Kushtetuese^[18], gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e

¹⁷ Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 12.12.2013.

¹⁸ Vendimi nr. 8, datë 16.03.2011; Vendimi nr. 23, datë 04.11.2008; Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008.

të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se edhe duke marrë në konsideratë shkaqet objektive (*ngarkesa e punës, kompleksiteti i çështjeve, shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare*), vendimet gjyqësore duhet të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm. Në çdo rast duhet të gjenden zgjidhje ligjore brenda institucionit në mënyrë që dorëzimi i tyre të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara, sepse vonesa të tilla ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cenohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor rezulton në një proces joefektiv.

Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm përbën një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ) dhe në referim të praktikës së GJEDNJ-së është përcaktuar se periodha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor^[19].

Arsyetimi i vendimit përbën një nga elementët e procesit të rregullt gjyqësor, pasi përmes tij palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces mund të njihen me argumentet mbi të cilat gjykata e ka mbështetur vendimmarrjen e saj dhe kanë mundësinë më tej për të parashtruar kundërshtimet e tyre në gjykatat e një niveli më të lartë. Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimit është një mjet me të cilin publiku i gjerë njihet me mënyrën e administrimit të drejtësisë nga gjykatat, duke ushtruar kontrollin e tij mbi respektimin e parimit të shtetit të së drejtës.

Në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar afati njëzetditor i arsyetimit të vendimit. Ky afat synon disiplinimin në mënyrë të arsyeshme të punës së gjykatës në lidhje me arsyetimin e vendimit. Gjykata duhet të marrë një kohë të arsyeshme për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimit në sekretari, kjo e fundit njofton kopjen e vendimit palëve të interesuara. Vendimi përfundimtar i gjykatës duhet t'u njoftohet palëve në zbatim të parimit të procesit të rregullt ligjor. Në lidhje me njoftimin e vendimit duhen mbajtur parasysh nenet 171/a (3)^[20] dhe 316^[21] të Kodit të Procedurës Civile.

¹⁹ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-65116>.

²⁰ "...Vendimet e shpallura jashtë seancës dhe ato, ndaj të cilave lejohet ankimi i veçantë u komunikohen palëve të interesuara nga sekretari i seancës jo më vonë se tre ditë nga shpallja e tyre..."

²¹ "...Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar..."

Në Kodin e Procedurës Penale parashikohet se pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe se kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ndërsa kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Në lidhje me njoftimin e vendimit duhet mbajtur parasysh neni 386/2 i KPP që përcakton se vendimi u njoftohet palëve në adresën e deklaruar prej tyre. Njoftimi i kryer në adresën e deklaruar nga palët konsiderohet i realizuar. Arsyetimi i vendimeve dhe depozitimi i tyre në sekretarinë e gjykatës për të vijuar më tej me njoftimin e vendimit palëve, është parashikuar në nene të ndryshme, pasi legjislatori ka mbajtur parasysh natyrën e ndryshme të çështjeve penale, por gjithashtu edhe natyrën e ngutshme të tyre, duke përcaktuar në mënyrë specifike për çështje të ndryshme afatet për arsyetimin e vendimit dhe sigurisht duke i qëndruar besnik parashikimit të nenit 382 të KPP, nëse afatet nuk janë përcaktuar specifikisht.

Parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Thënë kjo, efica në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura.

Vonesat e pajustificuara në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara pengojnë ecurinë normale të procesit të dhënies së drejtësisë dhe për pasojë dëmtojnë të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt gjyqësor; duke iu cenuar palëve të drejtën për të pasur arsyetimin e vendimit në mënyrë që të vlerësojnë kushtet e marrjes së tij dhe eventualisht për të disponuar me ushtrimin e së drejtës së ankimit; duke dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, për sa kohë tejkalimi i afateve logjike dhe normale, është thuajse i barabartë me mungesën e drejtësisë. Mungesa e arsyeve mbi të cilat bazohet vendimi për një afat të gjatë cenon thelbin e të drejtës së ankimit, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës^[22].

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013^[23], kanë elaboruar rrethanat në të cilat vonesat në arsyetimin e vendimit gjyqësor passjellin përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin. Në këtë vendim gjykata ka referuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ [.... konstatohet se kjo gjykatë në shumë çështje e ka konsideruar vonesën në arsyetimin e vendimeve gjyqësore si cenim të procesit të rregullt ligjor (neni 6 i Konventës). Në referim të vendimeve të kësaj gjykate, por edhe praktikës

²² Shih vendimin nr. 289, datë 18.04.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në çështjen L. Hoxha kundër KLD.

²³ Çështja me palë: paditës Neritan Tabaku, kundër të paditurit KLD-së, me objekt padi: kundërshtim vendimi të KLD-së për shkarkimin e paditësit nga detyra e gjyqtarit.



së saj në përgjithësi "case law", gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm "të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm". Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj "vonesave të tepruara procedurale", që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkon garantimin e procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm (neni 6)].

Nga shqyrtimi i të dhënave objekt inspektimi rezulton se numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk është i plotë sipas organikës, si pasojë e vendimmarrjeve të procesit të rivlerësimit kalimtar, daljes në pension dhe dorëheqjeve të gjyqtarëve. Ky proces natyrshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore duke krijuar një problematikë që ka të bëjë me sistemin në tërësi, duke bërë që gjyqtarët që ushtrojnë efektivisht detyrën të përballen me një volum të shtuar pune e duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rendimentin dhe efikasitetin e gjyqtarit. Kjo është një situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor për shkak të vakancave të krijuara e mosplotësimit të organikës.

Në vijim të analizës së mësipërme, ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, lidhur edhe me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magjistrateve për të arsyetuar vendimet gjyqësore i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse që ky vendim i drejtohet, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.

Sa i përket problematikave të konstatuara gjatë inspektimit të hasura në lidhje me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore duhet mbajtur në konsideratë se një faktor i rëndësishëm është edhe situata reale e administratës gjyqësore në gjykatat e vendit. Kjo e lidhur me mënyrën e organizimit të punës, realizimit të detyrave nga stafi përgjegjës i administratës gjyqësore, përgjegjësia e sekretarit të seancës për administrimin e dosjes si dhe e sekretarit gjyqësor për plotësimin e librit të pasqyrit të lëvizjes së dosjeve. si p. sh., kalimi i dosjes gjyqësore nga momenti i arsyetimit nga gjyqtari tek dorëzimi i arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Nga dokumentacioni i administruar gjatë inspektimit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier rezulton se nuk ka të dhëna mbi mbajtjen e regjistrit për kalimin e dosjes gjyqësore pas arsyetimit të vendimit nga gjyqtari tek sekretari i seancës ndërsa për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër rezulton se kolona "Data e dorëzimit nga gjyqtari tek sekretarja" është e njëjtë me kolonën "Data e dorëzimit në kryesekretari" pasi

Gjykata Shkodër nuk ka plotësuar të dhënat në kolonën përkatëse të regjistrimit mbi datën e dorëzimit të dosjes gjyqësore nga gjyqtari tek sekretarja.

Neni 13 i rregullores së veprimtarisë administrative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, miratuar me Urdhrin e datës 12.12.2014 të Kryetarit të Gjykatës parashikon se *"...Sekretari i seancës, veç detyrave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale e Civile, si dhe atyre që u caktohen nga gjyqtarët përgjatë dhe për shkak të procesit, kryen edhe përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të procesit gjyqësor, si dhe nga seanca në seancë, punon në mënyrë sistematike dhe në kohë reale me veprimet në sistemin ICMIS, siç është, planifikimi i seancave, regjistrimi i provave, ora e fillimit dhe e mbylljes së seancës, duke shënuar edhe shkaktuesin pse ajo ka filluar me vonesë deri tek hedhja e dispozitivit, vendimit të arsyetuar e mbyllja e çështjes në sistem, duke e dërguar tek kryesekretarja edhe në rrugë elektronike..."*.

Marrë në konsideratë sa më sipër, pavarësisht parashikimeve ligjore evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës. Në funksion të respektimit të afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore, do ishte e udhës që libri i pasqyrimit të lëvizjes së dosjeve të mbante datën e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari tek sekretari i seancës, nga sekretari i seancës tek sekretari gjyqësor, të numërtohet në çdo fletë, të nënshkruhet nga Kancelari/Sekretari i seancës/sekretari gjyqësor.

III. Gjetjet e inspektimit

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër janë përpunuar dhe trajtuar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, trajtimi në mënyrë shteruese i problematikave të dala gjatë realizimit të inspektimit rezulton se:


➤ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara dhe gjithashtu një trend të përgjithshëm mbi afatet e përgjithshme të dorëzimit të dosjeve në kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.


Gjatë përpunimit të të dhënave të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nga inspektorët përgjegjës u vunë re problematika në korrespondimin e datave të dorëzimit të dosjeve në kryesekretari dhe të njoftimeve të vendimeve nga ana e kryesekretarisë palëve ndërgjyqëse, ku një pjesë e vendimeve të padorëzuara në kryesekretari rezultojnë të njoftuara palëve, ose kishte mospërputhje të datës së dorëzimit dhe datës së njoftimit të vendimit palëve, ku data e njoftimit të palëve rezultonte përpara datës së dorëzimit të vendimeve. Por referuar përmbajtjes së shkresave përcjellëse të informacioneve të dërguara nga gjykata rezultojnë se: *“... Në disa raste në tabelën që kemi plotësuar data e njoftimit të palëve është para depozitimit të dosjes në kryesekretari, për shkak se sekretaret kanë dhënë vendimin për komunikim para dorëzimit të dosjes...”*. Gjithashtu në vazhdimësi të shkresave përcjellëse të kësaj gjykate në lidhje me informacionin mbi çështjet civile të veçanta dhe kërkesat civile, ndër të tjera sqarohet se *“...Për urdhrat e ekzekutimit të pranuar, mungon data e komunikimit të vendimeve, për shkak se për këto vendime nuk lejohet ankim dhe sipas ligjit hartohet në një kopje dhe në momentin e depozitimit të vendimit në kryesekretari, i dorëzohet palës kërkuese...”*. Këto problematika u konstatuan në 21 raste sa i përket çështjeve civile të themelit, të shpallura nga kjo gjykatë gjatë periudhës së inspektuar. Vetëm në dy raste u konstatua numërtimi i gabuar i vendimeve civile, të dyja këto raste u evidentuan si gabime njerëzore, të konstatuara dhe të rregulluara nga vetë sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate.

- Totali i vendimeve **civile të themelit** të shpallura për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 01.06.2023 është **496** vendime, nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor:	433 vendime ose 87.2 %.
Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor:	31 vendime ose 6.2 %.
Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor:	22 vendime ose 4.4 %.
Të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor:	9 vendime ose 1.8 %.
Të dorëzuara brenda afatit 91-20 ditor:	2 vendime ose 0.4 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 121 ditor:	0 vendime ose 0 %.
Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024:	0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve civile të themelit të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



- Totali i vendimeve për **kërkesat civile** të shpallura për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 01.06.2023 është **579** vendime, nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor: 489 vendime ose 92 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor : 31 vendime ose 5.8 %.

Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor : 11 vendime ose 2 %.

Të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor : 0 vendime ose 0 %.


Të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor: 1 vendim ose 0.2 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 121 ditor : 0 vendime ose 0 %.

Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024: 0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve për kërkesat civile të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Kërkesa Civile



Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare vjetore të një gjyqtari në këtë gjykatë 851.5 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpallura në sekretari dhe kryqëzuar me të dhënat e tabelës së mësipërme, rezulton se brenda afatit 60 ditor janë dorëzuar 96% e vendimeve, duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar^[24].

Nga trajtimi i të dhënave, mbi çështjet me karakter penal, të administruara gjatë inspektimit rezultoi si vijon:

Në zbatim të nenit 382, pika 3 të KPP, në të gjitha çështjet penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier konstatohet që në **49** çështje **penale themeli me të arrestuar** të përfunduara gjatë periudhës së këtij inspektimi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 15 ditor: 36 vendime ose 73.4 %.

Të dorëzuara brenda afatit 16-25 ditor: 4 vendime ose 8.2 %.

Të dorëzuara brenda afatit 26-50 ditor: 4 vendime ose 8.2 %.


Të dorëzuara brenda afati 51-60 ditor: 3 vendime ose 6.2 %.

²⁴ Në një analizë më të hollësishme lidhur me numrin e dosjeve të shpallura por të padorëzuara brenda afatit ligjor, u gjet mesatarja e kohës që i është dashur gjyqtarëve për të plotësuar këtë detyrë. Për të arritur në gjetjen e afatit që i është dashur gjyqtarëve për dorëzimin e dosjeve, u procedua duke zbritur nga numri i përgjithshëm i dosjeve të shpallura, brenda periudhës së inspektimit, numrin e dosjeve të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe numrin e dosjeve të padorëzuara ende deri në datën 10.05.2024 dhe del shuma e përgjithshme e dosjeve të dorëzuara tej afateve të parashikuara në ligj, pra dosjet e dorëzuara me vonesë. Në bazë të kësaj shume u përllogarit përqindja e dosjeve të dorëzuara brenda afatit 60 ditor dhe u mor si afat maksimal i dorëzimit të vendimeve të arsyetuara dhe dosjeve gjyqësore në sekretari.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 1 vendim ose 2 %.

Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024: 1 vendime ose 2 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



- Në zbatim të nenit 382, pika 2, për çështjet penale të themelit, ku i pandehuri nuk ndodhet me masë sigurimi personal, kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat rezultoi se nga totali prej **218** çështjesh:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 150 vendime ose 69 %.

Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor: 28 vendime ose 13 %.

Të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor: 29 vendime ose 13 %.


Të dorëzuara brenda afati 51-60 ditor: 9 vendime ose 4 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 2 vendime ose 1 %.

[Signature]

[Signature]

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve penale të themelit të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



- Në lidhje me çështje të kategorisë **“Seancë paraprake”** për çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” në zbatim të nenit 332 “dh”, germa “a” dhe “c”, rezulton se në total janë **232** çështje, nga të cilat **205** janë trajtuar sipas germës “c”, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar dhe për to është zbatuar afati i dorëzimit të çështjeve penale të themelit sipas nenit 382 të K. Pr. Penale dhe të **205** çështjet janë dorëzuar brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në ligj. Ndërkohë që **27** prej tyre kanë dalë me vendim për “Dërgimin në Gjyq” në zbatim të nenit 332 “dh”, germa “a” dhe afati i dorëzimit të tyre është 10 ditë, të cilat reflektohen si vijon:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 10 ditor: 20 vendime ose 74 %.


Të dorëzuara brenda afatit 11-20 ditor: 3 vendime ose 18.6 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor: 1 vendime ose 3.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 30 ditor: 1 vendime ose 3.7 %.

Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024: 0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të seancave paraprake të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Përsa i përket çështjeve penale të veçanta, që kanë objekt **“Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”** ose **“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”**, është llogaritur afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale. Rezultoi se në total për periudhën e inspektuar janë **170** çështje që lidhen me masat e sigurimit nga të cilat:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 5 ditor: 149 vendime ose 87.5 %.

Të dorëzuara brenda afatit 6-15 ditor: 8 vendime ose 4.7 %.


Të dorëzuara brenda afatit 16-30 ditor: 6 vendime ose 3.6 %.

Të dorëzuara brenda afati 31-60 ditor: 4 vendime ose 2.4 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 2 vendime ose 1.2 %.

Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024: 1 vendime ose 0.6 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të seancave të masave të sigurimit personal të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier



[Handwritten signatures]

sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Për **kërkesat penale**, për të cilat nuk përcaktohet afat specifik për dorëzimin e vendimit të arsyetuar, u përdor afati i përgjithshëm i dorëzimit prej 30 ditësh i parashikuar në nenin 382 të K. Pr. Penale. Kështu në totalin e **429** vendimeve të dhëna për kërkesa penale gjatë periudhës së inspektimit:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 354 vendime ose 81.8 %.


Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor: 48 vendime ose 11.2 %.

Të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor: 18 vendime ose 4.2%.

Të dorëzuara brenda afatit 51-60 ditor: 6 vendime ose 1.4 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 6 vendime ose 1.4 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave penale të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:




Në lidhje me kërkesat me objekt **“Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi”** sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezulton që në **9** përgjimet e kësaj periudhe të 9 ose 100% e tyre janë dorëzuar brenda afatit 24 orësh të përcaktuar nga neni 222/4 i K. Pr. Penale.

Përsa i përket kërkesave me objekt **“Shuarje mase sigurimi”**, në zbatim të nenit 261/3 dhe nenit 248/2 të K. Pr. Penale përcaktohet që vendimi i arsyetuar duhet të dorëzohet brenda afatit procedural 48 orëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat konstatohet se totali i vendimeve të shpallura për “Shuarje mase sigurimi” për periudhën e inspektimit është **27**, prej të cilave:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 2 ditor:	7 vendime ose 26 %.
Të dorëzuara brenda afatit 3-15 ditor:	10 vendime ose 37 %.
Të dorëzuara brenda afatit 16-30 ditor:	7 vendime ose 26 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 30 ditor:	3 vendime ose 11 %.
Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024:	0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave për shuarje mase, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:




Përsa i përket çështjeve penale për të cilat është vendosur **pushimi i procedimit penal**, të cilat trajtohen në zbardhje të vendimit sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar është 30 ditë. Në total pushime gjykimi për periudhën e inspektuar janë **119** çështje, nga të cilat:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor:	86 vendime ose 72.3 %.
Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor:	15 vendime ose 12.6 %.
Të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor:	16 vendime ose 13.4 %.
Të dorëzuara brenda afati 51-60 ditor:	2 vendime ose 1.7 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor:	0 vendime ose 0 %.
Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024:	0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve pushim gjykimi, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, pushime



Nga kontrolli i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjatë inspektimit, u hasën problematikat e mëposhtme:

- i. Nuk identifikohet data e dorëzimit të vendimit nga gjyqtari tek sekretarja e seancës pasi gjatë realizimit të inspektimit rezultoi se nuk ka një regjistër i cili pasqyron saktë të dhënat e mësipërme. Për rrjedhojë, nuk evidentohet data kur gjyqtari ka dorëzuar vendimin e arsyetuar sekretares së seancës.
- ii. Rezultoi se afati i realizimit të procedurës së njoftimit të vendimeve të arsyetuara nga sekretaria është maksimumi 3 ditor, duke mbajtur parasysh ngarkesën e ditës ose pushimet zyrtare dhe përgjithësisht nuk vërehen vonesa në veprimtarinë administrative të gjykatës.
- iii. Rezultoi se gjykata e inspektuar tregoi gatishmëri në bashkëpunimin për këtë inspektim tematik.


➤ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Gjykata e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Shkodër, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara dhe gjithashtu një trend të përgjithshëm mbi afatet e përgjithshme të dorëzimit të dosjeve në Kryesekretarinë e Gjykata e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Shkodër.

Totali i vendimeve civile të themelit të shpallura për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 01.06.2023 është **294** vendime nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor:	119 vendime ose 40.5 %.
Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor:	114 vendime ose 39 %.
Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor:	3 vendime ose 1 %.
Të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor:	0 vendime ose 0 %.
Të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor:	9 vendime ose 3 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 121 ditor:	15 vendime ose 5%.
Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024:	34 vendime ose 11.5 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve civile të themelit të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:




Totali i vendimeve kërkesave civile të shpallura për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 01.06.2023 është **426** vendime nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor:	350 vendime ose 82 %.
Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor:	38 vendime ose 9 %.
Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor:	3 vendime ose 0.8 %.
Të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor:	0 vendime ose 0 %.
Të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor:	5 vendime ose 1.2 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 121 ditor:	2 vendime ose 0.5%.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024:

28 vendime ose 6.5 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve për kërkesat civile të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Gjatë përpunimit të të dhënave të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nga inspektorët përgjegjës u konstatuan të dhëna të paqarta lidhur me datat e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari dhe të njoftimeve të vendimeve nga ana e kryesekretarisë palëve ndërgjyqëse. Një pjesë e vendimeve të padorëzuara në kryesekretari rezultonin të njoftuara palëve, ose kishte mospërputhje të datës së dorëzimit dhe datës së njoftimit të vendimit palëve, ku data e njoftimit të palëve rezultonte përpara datës së dorëzimit të vendimeve. Këto problematika u konstatuan në 21 raste përsa i përket çështjeve civile të themelit, të shpallura nga kjo gjykatë gjatë periudhës së inspektuar.

Me synim verifikimin e të dhënave dhe saktësimin e informacionit inspektorët përgjegjës kërkuar me anë të e-mailit zyrtar të datës 25.09.2024, informacion shtesë në lidhje me këto çështje, nga përgjigjja zyrtare e nisur nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, u verifikua që për këto çështje ka pasur lapsuse, pasi janë hedhur gabim të dhënat në tabelën e plotësuar sipas kërkesave të objektit të inspektimit. Pas rregullimit të tyre dhe pasqyrimit përfundimtar të informacionit të grumbulluar, informacioni rezultoi i plotë dhe pa problematika të tjera përsa i përket çështjeve civile të shpallura nga kjo gjykatë, për periudhën e inspektuar.

Përsa i përket **seksionit penal** të kësaj gjykate, pas informacionit të grumbulluar dhe përpunuar nga grupi i inspektimit, u kategorizuan çështjet sipas përcaktimeve për dorëzimin e vendime në Kodin e Procedurës Penale. Nga trajtimi i këtyre informacioneve rezultoi si vijon:

Në zbatim të nenit 382, pika 3 të K. Pr. Penale, në të gjitha çështjet penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër konstatohet që në **63** çështje **penale themeli me të arrestuar** të përfunduara gjatë periudhës së këtij inspektimi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 15 ditor: 35 vendime ose 55.5 %.


Të dorëzuara brenda afatit 16-25 ditor: 6 vendime ose 9.5 %.

Të dorëzuara brenda afatit 26-40 ditor: 15 vendime ose 23.9 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 40 ditor: 7 vendime ose 11.1 %.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024: 0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Në zbatim të nenit 382, pika 2, për çështjet **penale të themelit**, ku i pandehuri nuk ndodhet me masë sigurimi personal, kur vendimi shpallet i përmblodhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat rezultoi se nga totali prej **361** çështjesh:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 234 vendime ose 64.5 %.

Të dorëzuara brenda afatit 3-40 ditor: 66 vendime ose 18.5 %.


Të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor: 16 vendime ose 4.5 %.

Të dorëzuara brenda afati 51-60 ditor: 4 vendime ose 1.1 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 26 vendime ose 7.2 %.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024: 15 vendime ose 4.2 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve penale të themelit të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Në lidhje me çështje të kategorisë **“Seancë paraprake”** për çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” në zbatim të nenit 332 “dh”, germa “a”, rezulton se në total janë **111** çështje, ndërsa për ato që janë trajtuar sipas nenit 332 “dh”, germa “c”, për këtë gjykatë janë pasqyruar direkt në kategorinë e çështjeve penale themeli. Për këto 111 çështje për “Dërgimin në Gjyq” në zbatim të nenit 332 “dh”, germa “a” dhe afati i dorëzimit të tyre është 10 ditë, të cilat reflektohen si vijon:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 10 ditor: 83 vendime ose 74.8 %.


Të dorëzuara brenda afatit 11-20 ditor: 19 vendime ose 17.1 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor: 4 vendime ose 3.6 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 30 ditor: 5 vendime ose 4.5 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të seancave paraprake të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Seanca paraprake "a"



Përsa i përket çështjeve penale të veçanta, që kanë objekt **“Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”** ose **“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”**, është llogaritur afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale. Rezultoi se në total për periudhën e inspektuar janë **194** çështje që lidhen me masat e sigurimit nga të cilat:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 5 ditor: 57 vendime ose 29.4 %.

Të dorëzuara brenda afatit 6-15 ditor: 68 vendime ose 35 %.

Të dorëzuara brenda afatit 16-30 ditor: 29 vendime ose 15 %.


Të dorëzuara brenda afati 31-60 ditor: 2 vendime ose 1 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 10 vendime ose 5.2 %.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024: 28 vendime ose 14.4 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të seancave të masave të sigurimit personal të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Masa Sigurimi



[Handwritten signatures]

Për **kërkesat penale**, për të cilat nuk përcaktohet afat specifik për dorëzimin e vendimit të arsyetuar, u përdor afati i përgjithshëm i dorëzimit prej 30 ditësh i parashikuar në nenin 382 të K. Pr. Penale. Kështu në totalin e **435** vendimeve të dhënë për kërkesa penale gjatë periudhës së inspektimit:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 339 vendime ose 77.9 %.

Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor: 38 vendime ose 8.8 %.


Të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor: 20 vendime ose 4.6 %.

Të dorëzuara brenda afatit 51-60 ditor: 14 vendime ose 3.2 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 9 vendime ose 2 %.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024: 15 vendime ose 3.5 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave penale të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Në lidhje me kërkesat me objekt **“Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi”** sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, rezulton që janë vendimuar **75** përgjime.

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 1 ditor: 36 vendime ose 48 %.


Të dorëzuara brenda afatit 2-5 ditor: 33 vendime ose 44 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 6 ditor: 5 vendime ose 6.7 %.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024: 1 vendim ose 1.3 %.

Lidhur me të dhënat e mësipërme çmojmë të evidentojmë faktin se, kjo kategori çështjesh ka të bëjë me çështje të sekretit hetimor, ku vendimi i dorëzohet i arsyetuar prokurorit ndërsa në sekretarinë gjyqësore dorëzohet pasi të ketë humbur karakterin e saj si “sekret”. Në të dhënat e vlerësuara në kuadër të inspektimit nuk rezulton e qartë nëse afati i referohet arsyetimit të vendimit apo dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave penale të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:




Përsa i përket kërkesave me objekt **“Shuarje mase sigurimi”**, në zbatim të nenit 261/3 dhe nenit 248/2 të K. Pr. Penale përcaktohet që vendimi i arsyetuar duhet të dorëzohet brenda afatit procedural 48 orëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat konstatohet se totali i vendimeve të shpallura për **“Shuarje mase sigurimi”** për periudhën e inspektimit është **14**, prej të cilave:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 2 ditor:	3 vendime ose 21.4 %.
Të dorëzuara brenda afatit 3-15 ditor:	6 vendime ose 42.9 %.
Të dorëzuara brenda afatit 16-30 ditor:	1 vendim ose 7.1 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 30 ditor:	3 vendime ose 21.4 %.
Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024:	1 vendim ose 7.2 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave për shuarje mase, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Shuarje Mase



Përsa i përket çështjeve penale për të cilat është vendosur **pushimi i gjykimit**, të cilat trajtohen në zbardhje të vendimit sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar është 30 ditë. Në total pushime gjykimi për periudhën e inspektuar janë **572** çështje, nga të cilat:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 367 vendime ose 64.2 %.

Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor: 95 vendime ose 16.6 %.

Të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor: 20 vendime ose 3.5 %.


Të dorëzuara brenda afati 51-60 ditor: 10 vendime ose 1.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor: 57 vendime ose 10 %.

Të padorëzuara deri në datën 07.05.2024: 23 vendime ose 4 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve pushim gjykimi, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Pushime



Nga kontrolli i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë inspektimit u hasën problematikat e mëposhtme:

- I. Gjatë realizimit të procesit të inspektimit u evidentua se mungonte libri i pasqyrimt të lëvizjes së dosjeve (*pra kalimi i dosjes gjyqësore pas arsyetimit të vendimit nga gjyqtari tek sekretari i seancës*). Nuk identifikohet data e dorëzimit të vendimit nga gjyqtari tek sekretarja e seancës pasi gjatë realizimit të inspektimit rezultoi se nuk ka një regjistër i cili pasqyron saktë të dhënat e mësipërme. Për rrjedhojë, nuk evidentohet data kur gjyqtari ka dorëzuar vendimin e arsyetuar sekretares së seancës.
- II. Rezultoi se afati i realizimit të procedurës së njoftimit të vendimeve të arsyetuara nga sekretaria është maksimumi 5 ditor, duke mbajtur parasysh ngarkesën e ditës ose pushimet zyrtare dhe përgjithësisht nuk vërehen vonesa në veprimtarinë administrative të gjykatës.
- III. Rezultoi se gjykata e inspektuar tregoi gatishmëri në bashkëpunimin për këtë inspektim tematik.
- IV. **Konkluzionet**

Inspektimi u zhvillua dhe përfshiu veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër si dhe të dhënat e administruara nga gjykatat e sipërpërmendura, për periudhën e inspektimit, mundësuan njohjen dhe krijimin e një tabloje të përgjithshme mbi respektimin e afateve ligjore për arsyetimin e vendimeve të gjyqësore të shpallura si dhe depozitimin e tyre së bashku me dosjet në sekretari nga magjistratët gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës.

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2023 deri më 01.06.2023 rezultoi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë shpallur:

- **496 vendime civile të themelit** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 433 vendime ose 87.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 31 vendime ose 6.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 21-30 ditor, 22 vendime ose 4.4 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 31-60 ditor, 9

vendime ose 1.8 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 61-90 ditor, 2 vendime ose 0.4 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 91-120 ditor, 0 vendime ose 0% e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari mbi afatin 121 ditor, i padorëzuar deri në datën 20.05.2024 nuk rezulton asnjë vendim.

- **268 vendime penale themeli**, të cilat për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale, janë kategorizuar sipas natyrës së çështjes dhe afatit ligjor përkatës për arsyetimin e vendimit, në rastet kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij KPP, në total për periudhën e inspektuar janë **49 çështje** dhe në penale themeli të dënuar pa masë sigurimi personal, të cilat në total janë **219 çështje**. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier konstatohet që në 49 çështje penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 KPP, rezultojnë të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 15 ditor 36 vendime ose 73.4 %, të dorëzuara brenda afatit 16-25 ditor 4 vendime ose 8.2 %, të dorëzuara brenda afatit 26- 50 ditor 4 vendime ose 8.2 %, të dorëzuara brenda afatit 51-60 ditor 3 vendime ose 6.2 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor, 1 vendim ose 2 %, të padorëzuara deri në datën 20.05.2024 1 vendim ose 2 %. Në zbatim të nenit 382, pika 2, për çështjet penale të themelit, ku personi i dënuar nuk është në masë sigurimi personal kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat rezultoi se nga totali prej **218 çështjesh**, të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 150 vendime ose 69 %, të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor, 28 vendime ose 13 %, të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor 29 vendime ose 13 %, të dorëzuara brenda afatit 51-60 ditor 9 vendime ose 4 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor 2 vendime ose 1 %.
- **232 vendime të seancave paraprake**. Për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale neni 332/dh, janë kategorizuar sipas natyrës së vendimmarrjes dhe parashikimit ligjor përkatës. Në totalin e vendimeve të seancave paraprake për periudhën e inspektuar rezultuan që **205 çështje** janë vendimuar sipas germës “c”, për të cilat është vlerësuar dërgimi i çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi, të cilat u referohen afateve të parashikuara në nenin 382 të KPP për arsyetimin e vendimit dhe **27 çështje** të cilat janë trajtuar sipas germës “a”, të nenit 332/dh dhe për të cilat afati i parashikuar për arsyetimin e vendimit pas shpalljes së tij është 10 ditor. Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 10 ditor, 20 vendime ose 74 %, të dorëzuara brenda afatit 11-20 ditor, 3 vendime ose 18.6 %, të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor 1 vendim ose 3.7 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 30 ditor 1 vendim ose 3.7 %, të padorëzuara deri në datën 20.05.2024 nuk ka vendime të padorëzuara.
- **638 vendime kërkesa penale**, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat që lidhen me masat e sigurimit personat të cilat janë **170** për periudhën e inspektuar, kërkesat për

lejim përgjimi dhe zgjatje afati për lejim përgjimi të cilat janë **9**, kërkesat për shuarjen e masave të sigurimit të cilat për periudhën e inspektuar janë **27** dhe të gjitha kërkesat e tjera penale të cilat ngrihen pranë gjykatës pas dhënies së vendimit të themelit të cilat janë **432** për periudhën e inspektuar. Përsa i përket çështjeve penale, që kanë objekt **“Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”** ose **“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”**, është llogaritur afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të KPP. Rezultoi se në total për periudhën e inspektuar janë **170** çështje që lidhen me masat e sigurimit nga të cilat, të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 5 ditor 149 vendime ose 87.5 %, të dorëzuara brenda afatit 6-15 ditor 8 vendime ose 4.7 %, të dorëzuara brenda afatit 16-30 ditor 6 vendime ose 3.6 %, të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor 4 vendime ose 2.4 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor 2 vendime ose 1.2 %, të padorëzuara deri në datën 20.05.2024, 1 vendim ose 0.6 %.

- Numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është 21, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023 është 10.8 pra 51%. Ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është 851.5 çështje.
- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezulton se: 97.8 % e vendimeve civile të themelit, rreth 99 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 79.6 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve, secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.
- Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare të një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me 851.5 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpallura në sekretari rezulton se brenda afatit 60 ditor janë dorëzuar 97.8 % të vendimeve të shpallura.

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2023 deri më 01.06.2023, rezultoi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër janë shpallur:

- **294** vendime civile të themelit të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto, 119 vendime ose 40.5 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 114 vendime ose 39 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 21-30 ditor, 3 vendime ose 1 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 31-60 ditor, 9 vendime ose 3 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 91-120 ditor, 15 vendime ose 5% e totalit të

vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari mbi afatin 121 ditor.


- **424 vendime penale themeli**, të cilat për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale, janë kategorizuar sipas natyrës së çështjes dhe afatit ligjor përkatës për arsyetimin e vendimit, në rastet kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij KPP, për periudhën e inspektuar janë **63 çështje** dhe në penale themeli me të dënuar pa masë sigurimi personal të cilat në total janë **361 çështje**. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër konstatohet që në **63 çështje** ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 KPP, rezultojnë të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 15 ditor 35 vendime ose 55.5 %, të dorëzuara brenda afatit 16-25 ditor 6 vendime ose 9.5 %, të dorëzuara brenda afatit 26-40 ditor 15 vendime ose 23.9 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 40 ditor 7 vendime ose 11.1 %, 0 të padorëzuara deri në datën 07.05.2024. Në zbatim të nenit 382, pika 2, për çështjet **penale të themelit**, ku personi i dënuar nuk është në masë sigurimi personal kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat rezultoi se nga totali prej **361 çështjesh**, të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor 234 vendime ose 64.5 %, të dorëzuara brenda afatit 31- 40 ditor 66 vendime ose 18.5 %, të dorëzuara brenda afatit 41-50 ditor 16 vendime ose 4.5 %, të dorëzuara brenda afatit 51-60 ditor 4 vendime ose 1.1 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor 26 vendime ose 7.2 %, të padorëzuara deri në datën 07.05.2024, 15 vendime ose 4.2 %.
- **111 vendime të seancave paraprake**. Për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale neni 332/dh janë kategorizuar sipas natyrës së vendimmarrjes dhe parashikimit ligjor përkatës. Në totalin e vendimeve të seancave paraprake për periudhën e inspektuar rezultuan që dhe **111 çështje** të cilat janë trajtuar sipas germës “a”, të nenit 332/dh, dhe për të cilat afati i parashikuar për arsyetimin e vendimit pas shpalljes së tij është 10 ditor. Për këto 111 çështje për “Dërgimin në Gjyq” në zbatim të nenit 332 “dh”, germa “a” dhe afati i dorëzimit të tyre është 10 ditë, të cilat reflektohen si vijon të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 10 ditor 83 vendime ose 74.8 %, të dorëzuara brenda afatit 11-20 ditor 19 vendime ose 17.1 %, të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor 4 vendime ose 3.6 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 30 ditor 5 vendime ose 4.5 %.
- **718 vendime kërkesa penale**, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat që lidhen me masat e sigurimit personat të cilat janë **194** për periudhën e inspektuar, kërkesat për lejim përgjimi dhe zgjatje afati për lejim përgjimi të cilat janë **75**, kërkesat për shuarjen e masave të sigurimit të cilat për periudhën e inspektuar janë **14** dhe të gjitha kërkesat e tjera penale të cilat ngrihen pranë gjykatës pas dhënies së vendimit të themelit të cilat janë **435** për periudhën e inspektuar. Rezultoi se në total për periudhën e inspektuar janë **194 çështje** që lidhen me masat e sigurimit nga të cilat: të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 5 ditor 57 vendime ose 29.4 %, të dorëzuara brenda afatit 6-15 ditor 68 vendime ose 35 %, të dorëzuara brenda afatit

16-30 ditor 29 vendime ose 15 %, të dorëzuara brenda afati 31-60 ditor 2 vendime ose 1 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 60 ditor 10 vendime ose 5.2 %, të padorëzuara deri në datën 07.05.2024, 28 vendime ose 14.4 %.

- Numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është 15, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023 është 9.1 pra 61%. Ngarkesa mesatare e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është 829 çështje.
- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, rezulton se: 80.2 % e vendimeve civile të themelit, rreth 91.7 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 63.9 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve, secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.
- Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare të një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me 829 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve civile të shpallura në sekretari, rezulton se brenda afatit 60 ditor janë dorëzuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër 80.2% të vendimeve të shpallura.
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk ka funksionuar me organikë të plotë, pasi faktikisht gjatë vitit 2023 ka pasur 10.8 gjyqtarë pra 51%, pra gjysmën e organikës së saj, në raport me organikën 21 gjyqtarë (numrin e gjyqtarëve sipas dekretit).
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka funksionuar me organikë të plotë, pasi faktikisht gjatë vitit 2023 ka pasur është 9.1 gjyqtarë pra 61% në raport me organikën 15 gjyqtarë (numrin e gjyqtarëve sipas dekretit).
- Në rastin konkret, rezulton *prima facie* se, pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil (neni 308 i K. Pr. Civile), këto afate në shumicën e rasteve nuk janë zbatuar me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Në këtë rast, mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e magjistratëve nuk duhet të konsiderohet *apriori* si një shkelje e mundshme disiplinore. Për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor një sërë çështjesh të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e elementëve faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve sipas kërkesave të ligjit

nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Jo në çdo rast mosrespektimi i afateve të përcaktuara nga ana e legjislacionit procedural dhe në mënyrë të veçantë afatet e parashikuara për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohet si shkelje e mundshme disiplinore. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, apo aftësie profesionale të tilla që kalojnë "*kufirin e të arsyeshmes*" dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet nga ana e magjistratit. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore gjithashtu, kur përbën rast përsëritës, të rëndë dhe të pajustificuar, si dhe në të njëjtën kohë nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.
- Duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar në kuadër të vlerësimit të kohëzgjatjes së procedurave në lidhje me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore duhet të tregohet një qasje sa më e kujdesshme. Ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, lidhur edhe me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magjistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore, i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse që ky vendim i drejtohet, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.
- Në këtë kuadër, për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor të gjitha rastet ku afati i arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit gjyqësor tejkalon afatin, i cili konsiderohet si një "*kohë e arsyeshme*" që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.
- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, rezulton se, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier 97.8 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër 80.2 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor, duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e



arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezulton se: 97.8 % e vendimeve civile të themelit, rreth 99 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 79.6 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve, secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.
- Në këto kushte, paraprakisht vlerësohet se deri në momentin e kryerjes së inspektimit për dorëzimin e vendimeve civile të themelit, afati përcaktues dhe i domosdoshëm që duhet të merret në konsideratë, është afati 60 ditor si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, pasi vetëm ky afat mund të bëjë dallimin dhe të shërbejë si një kohë e arsyeshme në situatën konkrete të ngarkesës, organikës dhe numrit të magjistratëve, apo tipologjisë së çështjeve të gjykuara, mes nevojës për të arsyetuar dhe dorëzuar të gjitha vendimet gjyqësore, sipas afatit të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile dhe mundësisë dhe kapaciteteve aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për të respektuar këtë afat.

I. Rekomandimet

1. Për gjykatat subjekte të inspektimit:

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet gjykatave të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese me qëllim njohjet me problematikat e konstatuara.
- Rekomandohet mbajtja e një regjistri që të pasqyrojë datën e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari tek sekretari i seancës, datën e dorëzimit nga sekretari i seancës tek sekretari gjyqësor, të numërohet në çdo fletë, të nënshkruhet nga kancelari/sekretari i seancës/sekretari gjyqësor.
- Rekomandohet mbajtja e një regjistri për njoftimin e vendimit palëve në të cilin të evidentohet data e njoftimit të vendimit, me qëllim realizimin e kërkesave ligjore të nenit 171 dhe nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile, të cilët parashikojnë se vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit, ose në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.

2. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

Referuar gjetjeve të inspektimit vlerësohet se ka të dhëna lidhur me fakte që nëse provohen përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar sipas ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte rekomandohet:

- 1) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për vendimet gjyqësore civile të shpallura e të dorëzuara të arsyetuara në sekretari pas 60 ditëve nga shpallja.
- 2) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për vendimet gjyqësore civile të shpallura e të dorëzuara të arsyetuara në sekretari pas 60 ditëve nga shpallja.
- 3) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për vendimet penale të shpallura e të depozituara në sekretari në kapërcim të afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
- 4) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për vendimet penale të shpallura e të depozituara në sekretari në kapërcim të afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të ndryshuar,

PROPOZOJMË


1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 14, datë 02.04.2024 *“Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave*

të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Caktimin e periudhës nga data 12.05.2025 deri në datën 11.11.2025, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier si dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.

INSPEKTORËT

Erjena Bashari



Joana Sorraj

